

Fjala hyrëse e z. Ekaterina Trendafilova

Dita ndërkombëtare e përkujtimit të Holokaustit, 27 janar 2020

Shkëlqesi, kolegë të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Përpara se t'i kthehem thelbit të fjalës sime, dëshiroj t'ju them se ndihem shumë e përlurur që jam sot këtu në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit. Dëshiroj t'i shpreh mirënjohjen time të thellë ambasadorit të Izraelit, z. Naor Gilon, që më ka ftuar për të prezantuar ligjëruesin kryesor në këtë takim të sotëm, z. Filip Sands (Philippe Sands). Gjithashtu falënderoj ambasadën e Izraelit, bashkinë e Hagës dhe Qendrën CHAJ, organizatë e kulturës hebraike në Hagë, që kanë organizuar aktivitetin e sotëm përkujtimor.

Sot jemi mbledhur këtu për të kujtuar solemnisht krimet mizore që u kryen gjatë Holokaustit, kur njerëzimi e humbi rrugën e vet. Jemi mbledhur për t'u bërë homazh gjashtë milion hebrenjve dhe miliona të tjerëve të vrarë nga nazistët. Jemi mbledhur për të kujtuar brezat që humbën. Jemi mbledhur me shpresën se brezat e ardhshëm nuk do të harrojnë kurrë. Në këtë ditë, ne do të vazhdojmë të ndalojmë për të reflektuar mbi rëndësinë që ka një shoqëri e drejtë dhe paqësore – një shoqëri ku mbizotëron shteti ligjor dhe ku domethënia e këtyre fjalëve të shenjta është dhe do të vazhdojë të jetë: kurrë më.

Unë kam mësuar nga historia ime, nga populli im, se ndonjëherë duhet të bësh më shumë se sa thjesht të mbijetosh; se duhet të ngresh zërin për atë që është e drejtë. Unë kam lindur në Bullgari. Dihet që shteti im iu bashkua forcave të Aksit gjatë luftës. Por bashkatdhetarët e mi, qytetarët e Bullgarisë i kuptonin dhe i vlerësonin parimet e humanizmit. Ata e kuptonin se ndonjëherë, për të shpëtuar fqinjin – që do të thotë edhe të shpëtosh vetveten – duhet që të bashkohesh me të tjerët, duhet të ushtrosh tryzni mbi qeverinë tënde për të mbrojtur bashkëqytetarët e tu. Dhe kur nuk ke besim se qeveria jote do ta bëjë këtë, ndonjëherë duhet të shtrihesh mbi shinat e trenit për t'i shpëtuar shokët e miqtë, fqinjët dhe bashkatdhetarët, nga kampet e vdekjes, sepse kjo është e drejtë.

Kjo është ajo që ndodhi në Bullgari. Populli ynë i bëri trysni Parlamentit për të miratuar një ligj i cili ndalonte deportimin e më se 50 000 hebrenjve për në kampet e përqendrimit. Nga frika se qeveria do ta shpërfillte ligjin, qytetarë bullgarë shkuan në stacionet e trenit atë ditë që pritej të bëheshin deportimet. Ata ishin të gatshëm të shtriheshin mbi shina dhe trenat nuk u nisën. Sepse bullgarët e dinin - e dinin se njerëzit në rrezik duhen mbrojtur, e dinin se nuk duhet hequr dorë nga parimet e humanizmit.

Disa mund ta kenë harruar këtë pjesë të historisë, por unë nuk e kam harruar. Ajo më ka shërbyer si forcë shtytëse gjatë gjithë jetës sime dhe në punën time përkushtuar drejtësisë.

Edhe zotin Sands e ka karakterizuar i njëjti përkushtim tërë jetën. Ai ka punuar pa u lodhur gjatë gjithë karrierës së tij si shkrimtar, si jurist i shquar i të drejtave të njeriut, pedagog i drejtësisë dhe anëtar i bordeve dhe komiteteve të ndryshme, për të siguruar që personat të cilët kanë më shumë përgjegjësi për kryerjen e krimeve mizore të nxirren para përgjegjësisë, për të siguruar që historitë e panjohura të tregohen, për të siguruar që ne të mos harrojmë kurrë.

Aftësia e z. Sands për hedhur dritë mbi aspekte të historisë, për të zbuluar fakte dhe për të treguar histori nga këndvështrimi njerëzor, qoftë përmes punës së tij për mbrojtjen e të drejtave të njeriut apo përmes shkrimeve të tij, është me të vërtetë e pashoqe. Kureshtja e pashuar dhe vendosmëria e z. Sands e bënë atë të zbulonte fijet që lidhnin dy studiues të shquar të fushës së drejtësisë, Hersch Lauterpacht dhe Raphael Lemkin, në librin e tij të mrekullueshëm përkujtimor "*East West Street*" (Rruga Lindje-Perëndim). Aty tregohet historia e dy burrave që janë gjigandë të së drejtës ndërkombëtare, aty tregohet historia e lindjes së koncepteve juridike, ekzistenca e të cilëve nuk është vënë kurrë në dyshim. Eksplorimi që i ka bërë ai jetës së këtyre dy burrave në kontekstin e kërkimit të rrënjëve të tij është një përshkrim i vërtetë i historisë, i një historie me rëndësi të madhe, sidomos në fushën tonë.

Sot ne e marrim si të qenë këtë rend botëror që u ndërtua prej hirit të Holokaustit – Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, humanizmi ynë i përbashkët. Ne i pranojmë si të qena vetë nocionet për të cilat ka shkruar me kaq elokuencë z. Sands –

tri nocionet mbi të cilat mbështetemi sot për të nxjerrë para përgjegjësisë ata që kanë më shumë përgjegjësi për krime mizore: gjenocid dhe krime kundër njerëzimit.

Sot që jemi mbledhur këtu, 75 vjet pas çlirimit të Aushvicit, Holokausti po del gradualisht nga kujtesa e gjallë e brezave dhe po hyn në histori. Largësia më e madhe në kohë nga këto ngjarje bën që vepra e z. Sands të marrë shumë më tepër rëndësi. Në një kohë që shtetet po i kthejnë sytë vetëm brenda vetes, kur udhëheqësit botërorë po venë në dyshim vetë domosdoshmërinë e institucioneve ndërkombëtare që u krijuan për të parandaluar një Holokaust tjetër, ne duhet t'i bëjmë zërat tanë kolektivë që të dëgjohen. Nuk duhet të heqim dorë pikërisht nga ato themele mbi të cilat janë ngritur liritë tona.

Sikurse ka treguar edhe z. Sands gjatë gjithë karrierës së tij të shquar, ne nuk duhet të flemë mbi dafina e as nuk duhet të jemi pesimistë për të ardhmen e rendit tonë botëror. Secili prej nesh e ka për detyrë të kujtojë ato që kanë ndodhur gjatë Holokaustit. Ne duhet të vazhdojmë ta lëvizim botën, sado e papërkryer që është, drejt drejtësisë, t'i përmbahemi parimeve të shtetit ligjor, të kujdesemi për humanizmin tonë të përbashkët, dhe të shtrihemi mbi shinat e trenit nëse është nevoja. Dhe me të vërtetë, nëse ka diçka që *East West Street* e bën tejet të qartë, është ndikimi që individët mund të kenë në rrjedhën e historisë.

Siç është shprehur edhe Elie Wiesel, "*mund të ketë kohë kur jemi të pafuqishëm ta parandalojmë padrejtësinë, por asnjëherë nuk duhet ketë kohë që të mos ngrihemi në protestë*". Z. Sands nuk ka pushuar kurrë së ngrituri zërin dhe nuk e ka ndalur kurrë protestën e tij. Kam nderin t'ju prezantoj një njeri i cili e ka bërë historinë e figurave të ndritura të drejtësisë penale ndërkombëtare kaq të qartësisht pranishme në prozën e tij, një njeri që ngre zërin për çka është e drejtë dhe që i qëndron fjalës së dhënë.

Tani, me kënaqësinë dhe respektin më të madh, ia jap fjalën kolegut tim të nderuar, z. Filip Sands.